



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. M-7429 /2026

Klinë, datë 31/03/2026

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, nenit 14 dhe 20 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, nr.06/L-084 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.14/2019, dispozitat e nenit 5, 6 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ të QRK-së, nr.06/2022 për Themelimin dhe Funkcionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, më qellim të përmbushjes së obligimeve ligjore, kryetari i komunës mori, **ketë**:

V E N D I M

Për themelimin e ekipit për të drejtat e fëmijës

1. **THEMELOHET**, Ekipi për të Drejtat e Fëmijëve në Komunën e Klinës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, kryesues;
 - 1.2. Agron Bacaj, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, zv. kryesues;
 - 1.3. Qemajl Sejdiq, Drejtoria e Arsimit, anëtarë;
 - 1.4. Rexhë Buqani, Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport, anëtarë;
 - 1.5. Faruk Smajli, Drejtoria për Financa, anëtarë;
 - 1.6. Një anëtarë i deleguar nga Komiteti për Politike dhe Financa;
 - 1.7. Një anëtarë i deleguar nga Komiteti për Komunitete;
 - 1.8. Vitore Shala, zyrtare për barazi gjinore;
 - 1.9. Saibe Shala, Policia e Kosovës në Klinë;
 - 1.10. Ilir Bacaj, Qendra për Pune Sociale, anëtarë;
 - 1.11. Një përfaqësues nga shoqëria civile, anëtarë.
2. Në cilësi të anëtareve vëzhgues dhe këshilltareve të jashtëm do të jenë:
 - 2.1. Erza Agushi, përfaqësuese e fëmijëve/grupit të fëmijëve;
 - 2.2. Shaqir Gashi, përfaqësues i këshillit të prindërve;
 - 2.3. Një përfaqësues nga zyra rajonale e Institucionit të avokatit të Popullit;
 - 2.4. Vitore Zefi, përfaqësuese e organizatave vendore;
 - 2.5. Suad Sadikoviq, përfaqësues i Organizatave Ndërkombëtare.
3. Numri i përfaqësimit dhe delegimi i emrave nga pika 1 dhe 2 e këtij vendimi behet në dakordim paraprak dhe përmes një konsensusi ndërmjet përfaqësuesve potencial, ndërsa sekretar i ekipit caktohet **Astrit Muhaxheri**.
4. Ekipi për të drejtat e fëmijës punën e vet e kryen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, nr.06/L-084, Udhëzimit Administrativ të QRK-së nr.06/2022 për Themelimin dhe Funkcionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, si dhe akteve tjera pozitive të kësaj fushe.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Të njoftohen:

- Të përmendurit;
- QRK- Zyra për Qeverisje të Mire;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

